



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT SHKODËR

Nr. Regj. Them. 132 (00265)
Datë 28.03.2018

Nr. Vendimi 94
Datë 05.04.2018

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër i përbërë nga gjyqtaret:

Kryesuese	Valbona VATA
Anëtar	Luan DERVISHI
Anëtare	Marina RRABOSHTA



me sekretare seance **Etleva Ahmeti**, më datë **05.04.2018**, në seancë gjyqësore publike, mori në shqyrtim çështjen penale administrative që i përket palëve:

KËRKUESE:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë përfaqësuar nga Prokurori i Apelit Shkodër, **Elvin Gokaj**.

OBJEKTI:

Heqjen e sekuestros preventive mbi pasurinë e luajtshme, konkretisht automjetin me targë A/ Γ e markës Land Rover, model Range Rover Vogue, ngjyrë e bardhë, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit L K L pasi ajo ndryshuar pronësi që në vitin 2016 dhe aktualisht është në pronësi të shtetasit A B

Mbi ekzekutimin e vendimit mbi heqjen e sekuestros preventive të sipërpërmendur të ngarkohet oficeri i policisë gjyqësore Thoma Zisi.

BAZA LIGJORE:

Neni 274/3 të K.Pr.Penale

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr.48, datë 27.02.2018, ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga cilido që ka interes në Gjykatën e Apelit Shkodër brenda 10 ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke parashtruar këto shkaqe për ankimin:

- Nuk jemi dakort me vendimin e gjykatës si një vendim jo i drejtë dhe i pabazuar në prova dhe në ligj;
- Masa e vendosjes së sekuestros konservative është një masë paraprake që organi i akuzës i kërkon gjykatës në fazën e hetimeve paraprake me qëllim pengimin e tjetërsimit të pronës së luajtshme apo llogarive bankare nga subjekti i dyshuar se ka kryer veprën penale;
- Automjeti me targë A. T rezulton në pronësi të një personi tjetër që në vitin 2016 pra efekti i tjetërsimit të kësaj pasurie nuk ekziston më;
- Kjo pasuri rezulton të jetë e tjetërsuar para fillimit të procedimit penal dhe pronari i pasurisë e ka fituar atë në mënyrë të ligjshme dhe ai nuk mund të privohet nga e drejta pronësore dhe poseduese;
- Pronari i kësaj pasurie nuk e ka fituar atë si pasojë e një veprimtarie kriminale por e ka fituar atë në mirëbesim.

Në përfundim të ankimit është kërkuar ndryshimin e vendimit penal nr.48 datë 27.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Heqjen e sekuestros preventive mbi automjetin me targë A. T parashikuar nga neni 274/3 të K.Pr.Penale.

GJYKATA E APELIT SHKODËR,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtares Valbona Vata;

dëgjoi prokurorin e apelit që kërkoj: heqjen dorë nga ankimi;

si edhe pasi e shqyrtoi çështjen;

VËREN

Pranë kësaj gjykate ka ardhur për gjykim çështja administrative penale kërkuar Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me objekt: Heqjen e sekuestros preventive mbi pasurinë e luajtshme, konkretisht automjetin me targë A. T e markës Land Rover, model Range Rover Vogue, ngjyrë e bardhë, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit L K L , pasi ajo ndryshuar pronësi që në vitin 2016 dhe aktualisht është në pronësi të shtetasit A B Mbi ekzekutimin e vendimit mbi heqjen e sekuestros preventive të sipërpërmendur të ngarkohet oficeri i policisë gjyqësore Thoma Zisi.

Rezultoi se para fillimit të gjykimit të çështjes, në momentin procedural të kërkesave paraprake, prokurori i kërkoj gjykatës:
“Heqjen dorë nga ankimi i bërë kundër vendimit nr.48 datë 27.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Në pretendimet e tij prokurori u shpreh vendimi i gjykatës duhet të lihet në fuqi pasi e vlerësoj si një vendim të drejtë dhe të bazuar në prova në ligj.

Gjykata e Apelit e ndodhur në këto kushte, mori në analizë nenin 420 pika 1 shkronja “ç” të K.Pr.Penale ku parashikohet se:

Në nenin 420 pika 1 të K.Pr.Penale parashikohet se:

1. Me përjashtim të rasteve kur konstatohet në seancë, ankimi nuk pranohet në dhomë këshillimi:

- a) kur është bërë nga ai që nuk është i legjitimuar;*
- b) kur vendimi është i paankimueshëm;*
- c) kur nuk janë respektuar dispozitat për formën, paraqitjen, dërgimin, njoftimin dhe afatin e ankimit;*
- ç) kur është hequr dorë nga ankimi. ...etj*

2- Mospranimi mund të deklarohet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë procedimi”.

Në këto kushte, trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër mbështetur në nenin 420 pika 1 shkronja “ç” të K.Pr.Penale vlerëson se duhet vendosur mospranimi i ankimit të bërë nga prokurori kundër vendimit nr.48 datë 27.02.2018 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata e Apelit Shkodër, bazuar dhe në nenin 420 pika 1 shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI

Mospranimin e ankimit të paraqitur nga Prokuroria pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë kundër vendimit nr.48 datë 27.02.2018 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
Shkodër, më 05.04.2018.

ANËTARE
Marina RRABOSHTA
d.v

ANËTAR
Luan DERVISHI
d.v

KRYESUESE
Valbona VATA
d.v

Vërtetohet njësisht me origjinalin
KRYESEKRETARE
Mimoza NDOCI

